
MANAGEMENT AND BUSINESS EFFICIENCY OF ENTERPRISES TRADE IN KOSOVO

Violeta KoleciBiznesi College – Prishtina, Kosovo, violeta.koleci@hotmail.com

Abstract: An important role for the country's economic development is the adaptation of structural changes, opportunities and development conditions based on market demands for the products and services realized. The development of industry and natural resources are of particular importance in this regard.

The industry contributes mostly to economic development and division of labor. It provides opportunities for the reconstruction and advancement of other economic branches such as agriculture, traffic, trade and more. The influence of industry on transforming the country's economic and social structure is high or low, depending on the level of overall economic development of the country.

The post-war Kosovo economy faced great challenges, as a result of poor management for a decade and a devastating war. Nevertheless, Kosovo successfully passed the reconstruction phase, which was quite difficult. The beginning of privatization, the dynamic development of the private sector in small and medium enterprises, with particular emphasis on the production sector, the first initiatives of the integration process with the region's economy through the signing of the Free Trade Agreement, the inclusion in the Stability Pact as unequal only the first steps of long and serious processes towards the development of market economy and integration into regional and international institutions. In the post-war period, Kosovo's economy was a consumption economy and its needs largely met by imports, using "cash" as a means of payment in the absence of organized financial institutions. The economic structure of a country, for economic development, more than any other indicator represents the development and development reality. So it is treated as the current generator at all times and in every contemporary society.

In this paper we tried to define the management and efficiency of small and medium-sized businesses, and we also understood the importance and contribution of SMEs in economic development. Almost no definition is the same as what small and big business differentiates. The main factor in which theorists and economists are based is the number of employees.

Keywords: Kosovo economy, economic development, SME management, trade enterprises, statistical notes.

**MENAXHIMI DHE EFIKASITETI AFARISTË I NDËRMARRJEVE
TREGTARE NË KOSOVË****Violeta Koleci**Kolegji Biznesi Prishtinë, Kosovo, violeta.koleci@hotmail.com

Abstrakt: Rol të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit ka përshtatja e ndryshimeve strukturale, e mundësive dhe e kushteve të zhvillimit të bazuara në kërkesat e tregut për produktet dhe shërbimet e realizuara. Zhvillimi i industrisë dhe resurset natyrore janë të një rëndësie të veçantë në këtë drejtim.

Industria i kontribuon më së shumti zhvillimit ekonomik dhe ndarjes së punës. Ajo krijon mundësi për rindërtimin dhe avancimin e degëve të tjera ekonomike si bujqësisë, komunikacionit, tregtisë e të tjera. Ndikimi i industrisë në transformimin e strukturës ekonomike dhe sociale të vendit është i lartë ose i dobët, varësisht nga niveli i zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të vendit.

Ekonomia e Kosovës pas luftës është ballafaquar me sfida të mëdha, si pasojë e menaxhimit të dobët për një dekadë të tërë dhe e luftës shkatërrimtare. Megjithatë, Kosova me sukses e kaloi fazën e rindërtimit, e cila ishte mjaft e vështirë. Fillimi i privatizimit, zhvillimi dinamik i sektorit privat në ndërmarrje të vogla dhe të mesme, me theks të veçantë sektori i prodhimit, nisimat e para të procesit të integritimit me ekonominë e rajonit përmes nënshkrimit të marrëveshjes për tregti të lirë, inkuadrimi në Paktin e Stabilitetit si anëtare jo e barabartë, janë vetëm hapat e parë të proceseve të gjata dhe të rënda drejt zhvillimit të ekonomisë së tregut dhe integritimit në institucionet rajonale dhe ndërkombëtare. Në periudhën e pasluftës, ekonomia e Kosovës ishte ekonomi konsumuese dhe nevojat e veta kryesisht i plotësonte nga importi, duke e përdorur "keshin" si mjet pagese në mungesë të institucioneve të organizuara financiare. Struktura ekonomike e një vendi, për zhvillimin ekonomik, më tepër se cilido tregues tjetër paraqet kahet dhe realitetin zhvillimor. Pra, ajo trajtohet si gjenerator aktual në çdo kohëdhe në çdo shoqëri bashkohore.

Në këtë punim jemi munduar që të përkufizojmë menaxhimin dhe efikasitetin e bizneseve të vogla dhe të mesme, po ashtu kemi kuptuar rëndësinë dhe kontributin e NVM-ve në zhvillimin ekonomik. Pothuajse asnjë përkufizim nuk është i njëjtë me atë se çfarë i dallon bizneset e vogla nga ato të mëdha. Faktori kryesor në të cilin bazohen teoricienët dhe ekonomistët është numri i të punësuarve.

Fjalët kyç: Ekonomia e Kosovës, zhvillimi ekonomik, menaxhimi i NVM-ve, ndërmarrjet tregtare, shënimet statistikore.

HYRJE

Duke e ditur se ndërmarrjet përballen me shumë sfida gjatë punës së tyre, jemi munduar që këtë temë ta shtjellomë më mjaftë përkushtim. Qëndrueshmëria ekonomike e një vendi mbështetet në nivelin e zhvillimit të bizneseve dhe ndikimin e tyre të përgjithshëm në faktorët mikro dhe makroekonomik.

Në këtë punim jemi munduar që të përkufizojmë menaxhimin dhe efikasitetin e bizneseve të vogla dhe të mesme, po ashtu kemi kuptuar rëndësinë dhe kontributin e NVM-ve në zhvillimin ekonomik. Pothuajse asnjë përkufizim nuk është i njëjtë me atë se çfarë i dallon bizneset e vogla nga ato të mëdha. Faktori kryesor në të cilin bazohen teoricienët dhe ekonomistët është numri i të punësuarve.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) kanë një rol ekonomik dhe social shumë të rëndësishëm, për shkak të kontributit të tyre në funksionimin e rritjes ekonomike dhe në krijimin e vendeve të punës. Këto kontribute janë shumë të vlershme në kushtet e krizës dhe të rritjes së papunësisë. Sidomos në Kosovë, zhvillimi i NVM-ve mund të kontribuojë në përballimin e sfidave të shumta të lidhura me zhvillimin ekonomik, efektet e pabarazisë, nivelin e lartë të papunësisë, rritjen demografike dhe nevojën për ndryshime strukturale.

Duke u nisur nga fakti që ndërmarrësia si kulturë dhe koncept i të menduarit ekonomik, paraqitet si një resurs i rrallë, si agjent i ndryshimeve shoqërore (dhe politike). Krijimi i mjedisit për ide dhe iniciativa të reja, përkatësisht ndërtimi i sistemitë e stimulon dhe motivon njerëzit për të ndërmarrë diçka në lëmin e biznesit paraqet esencën e mardhënieve sociale kapitale të caktuara për zhvillimin e mentalitetit ndërmarrës. Kosova ka bazë të mirë për zhvillimin e sektorit privat.

Korniza e ligjore dhe rregullative e saj është e bazuar në praktikën më të mira në sektorin privat që janë edhe stimuluese për zhvillimin e sektorit të privat. Euroja stabile është valutë e vendit. Po ashtu ekzistojnë forca konkurruese në tregun e mallrave dhe shërbimeve. Sektori privat luan rol në rritje në çdo ekonomi kombëtare dhe kontribuon në punësim, të hyrat nga taksat, rritje ekonomike dhe kultivim të sistemit të tregut.

Në Kosovë, sektori privat përbëhet nga ndërmarrjet mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) përbëjnë rreth 98% të të gjitha ndërmarrjeve në Kosovë dhe kanë potencial që të luajnë rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike. Ky është gjithashtu pajtim i përgjithshëm në lidhje me rolin e rëndësishëm që NVM-të luajnë në punësim.

1. RËNDËSIA E NVM-VE

Ndërmarrjet “mikro dhe ato të vogla” zënë një peshë të madhe në ekonominë e një vendi.

Kontributi që ato jepin në rritjen, krijimin e punësimit dhe zhvillimit social është për tu vlerësuar.

Si studiusit dhe mbarë opinioni publik kanë njohur rëndësinë e madhe që ato kanë. Madje shpesh herë ato konsiderohen si “ lokomotiva e rritjes ekonomike”. Përgjithësisht rreth 65% e totalit të numrit të punonjësve janë të punësuar pranë bizneseve të vogla dhe mikro.

Ndërsa në vendet në zhvillim NVM punësojnë rreth 22% të popullsisë në moshëmadhore. Gjatë viteve të mëparshme, pjesa më e madhe e studimeve kanë patur si objekt studimi bizneset e mëdha.

Kjo për arsye se, deri në 1970, zhvillimi ekonomik ishte arritur kryesisht përmes prodhimit në masë që ofronin ato. Që atëherë, është vënë re një tendencë e ndryshme drejt: zvogëlimit të prodhimit dhe kjo ka rritur ndjeshëm rëndësinë tregtare të bizneseve të vogla. Për sa i përket studimit të tyre, për një kohë të gjatë, ka mbizotëruar një hamendësim i heshtur se teoritë dhe modelet organizative të zhvilluara mbi bizneset e mëdha ishin drejtpërsëdrejti të zbatueshme edhe për NVM-të. Megjithatë kanë konstatuar se në ditët e sotme pranohet gjerësisht se bizneset e vogla ndryshojnë shumë nga atë mëdhatë. Nuk ka dyshim se bizneset e vogla mbeten ekonomikisht të rëndësishme në çdo shoqëri të lirë të industrializuara. Ato marrin pjesë në poshtuajse çdo sektor të madh të ekonomisë, dhe vazhdojnë të sigurojnë një nivel të lartë punësimi jo vetëm në industritë tradicionale si ndërtimi, por edhe në sektorë më të rinj siq janë shërbimet profesionale dhe shkencore. Sipas studimeve në nivel Bashkimi Evropian (BE), bizneset mikro, të vogla dhe të mesme luajnë një rol të rëndësishëm në ekonomi. Ato janë një burim i madh aftësish sipërmarrëse, risish dhe mundësi punësimi. Në bazë të një studimi të kryer në vitin 2005, në rang BE-ja, rezultoi se rreth 23 milion NVM ofronin rreth 75 milionë vende pune dhe përfaqësonin 99% të të gjitha bizneseve. E siç do të thoshte edhe vetë komisioneri për sipërmarrjet dhe industrinë, Günter Verheugen:

“Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NVM) janë motori i ekonomisë Evropiane. Ato janë një burim thelbësor i vendeve të punës, krijojnë një frym sipërmarrëse dhe sjellin risi në BE dhe në këtë mënyrë janë të rëndësishme për nxitjen e konkurrencës dhe punësimit”.

Po ashtu edhe në rang global, bizneset e vogla përbëjnë shumicën e bizneseve në të gjitha ekonomitë në botë. Ato gjithashtu japin një kontribut të madh në prodhimin dhe punësimin së sektorin privat, një kontribut që më kalimin e kohës është në rritje. Fakti që ka kaq shumë biznese të vogla në ekonominë më të zhvilluar qon në ngritjen e një sërë pyetjesh, veqanërisht në atë se si mund të matim saktësisht sa biznese ekzistojnë në një ekonomi në një kohë të caktuar. Shumë biznese të vogla qëllimisht nuk regjistrohen pranë autoriteteve shtetërore. Të tjera kanë një jetëgjatësi aq të shkurtër sa autoritetet shtetërore nuk arrijnë të regjistrojnë ekzistencën e tyre përpara se ato të pushojnë së ekzistuari.

Së fundmi, shumë nga bizneset janë aq të vegjël sa shteti nuk mund të marrë në konsideratë si të vlefshëm për t’i regjistruar, dhe këto ndërmarrje janë përjashtuar nga detyrimi për tu regjistruar mbi bazë madhësisë. Kjo gjë shkakton probleme në aspektin e matjes së madhësisë së sektorit të bizneseve të vogla, kontributin e tyre në prodhim dhe punësim, në bërjen e matjeve nëse ky fenomen ndryshon gjatë një periudhe të caktuar kohe dhe në bërjen e krahasimeve me vende të tjera. Për të gjitha këto arsye, statistikën e bizneseve të vogla kanë të ndencë të jenë disi spekulative. E megjithatë kur flasim për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), mbi bazën e një logjike të thjeshtë praktike është e evidente se ato kanë një rëndësi të veçantë për rritjen e sektorit privat. Përdorimi i gjerë i termit “NVM” në përcaktimin e politikave të zhvillimit ekonomik ka lënë të kuptohet se segmenti i bizneseve që zënë hapësirën ndërmjet sipërmarrjeve mikro dhe atyre të mëdha paraqet mundësi dhe sfida dukshëm të ndryshme nga ato të dy grupeve të tjera.

2. KARAKTERISTIKAT E NVM-VE

Përpara se të japim një përkufizim të NVM-ve le të shohim cilat janë karakteristikat tipike të tyre sipas disa studiusve. Në mënyrë të përmblodhur ato janë si më poshtë:

Janë shumë fleksibël. Përparësia kryesore konkurruese e NVM-ve është fleksibiliteti i tyre; shpesh ato janë të afta të përbushin shpejt kërkesat dhe nevojat e konsumatorëve

Sjellin inovacion. Inovacioni përmes një programi kërkimi dhe zhvillimi është jetik për ekzistencën e një NVM-je tipike.

Të shpejta në zbatimin e vendimeve të marra. Ato karakterizohen nga zbatim i shpejtë i vendimeve të marra për të zbutur kërcënimet e jashtme dhe për të kapitalizuar mundësitë

Integrim vertikal. NVM-të janë më tepër të integruara vertikalisht se sa kategoritë e tjera të bizneseve, pasi ka më pak nivele administrimi dhe burokraci. Kjo lehtëson menaxhimin e tyre, por nga ana tjetër kjo ka një mangësi, pasi bën që NVM-të të përqendrohen më tepër në çështjet operative.

Suksesi varet nga aftësitë e shefit ekzekutiv. Personaliteti i shefit ekzekutiv të një NVM-je ose drejtori ekzekutiv është një element kyç në menaxhimin, rritjen, dhe suksesin e biznesit. Kështu, NVM-të janë më shpesh të orientuara nga njerëzit.

Mungesa e pajtueshmërisë me kërkesat për marrëdhëniet e punës. Tek NVM-të, marrëdhëniet e punës janë shpesh të lira dhe informale; mungon procesi i standardizimit.

Procedura politike-bërëse tërësisht të ndryshme nga ato të bizneseve të mëdha. Procedurat e hartimit të politikave dhe shfrytëzimi i burimeve që janë të përshtatshme për bizneset e mëdha nuk janë doemos të përshtatshme për NVM-të.

3. ROLI I NVM-VE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Fleksibiliteti ndaj ndryshimeve që ndodhin në mjedis, inovacioni, ndikimi në punësim, rritja e dinamikës ekonomike e bëjnë sektorin e NVM-ve jo vetëm atraktiv po edhe të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe strategjik. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë shtylla kurrizore e sektorit privat te cilat përbëjnë mbi 90% të ndërmarrjeve në mbarë botën dhe të cilat kontribuojnë në 50-60% të punësimit. Sot është mjaftë e dukshme që modeli ekonomik komandues nuk është më i preferuar për vendet te cilat kërkojnë zhvillim ekonomik, andaj shembja e sistemit centralizues në pjesën Ballkanike i ka hapur rrugë zhvillimit të sektorit privat dhe me këtë duke i`a mundësuar edhe kësaj pjese të Evropës të drejtohet drejt ekonomisë së lirë të zgjedhjes së individit, duke konsistuar në lirinë e zgjedhjes së konsumatorit në mes produkteve dhe shërbimeve konkurruese, dhe në lirinë e prodhuesve dhe ndërmarrësve të ri për te filluar një pune të re, apo zgjerim te biznesit ekzistues. Sektori i NVM-ve siguron mundësi të mira financiare dhe mundësi për të bërë pasuri, andaj edhe shume kompani në kuadër te këtij sektori janë kompani inovuese, me ide të qarta, gjë që e bënë këtë sektor të jetë i rëndësishëm në zhvillim e ekonomive kombëtare dhe ndërkombëtare. Në periudhën e pasluftës ekonomia e Kosovës ka qenë e varur nga ndihmat ndërkombëtare, sektori publik si dhe remitencat. Kjo periudhe ka identifikuar edhe disa barriera të cilat kanë ndikuar në zhvillim jo të shpejte të NVM-ve, ndër pengesat kryesore kane qenë furnizimi jo i qëndrueshëm me energji elektrike, ujë, qasja e kufizuar ne financa si dhe një nder pikat me te ndjeshme sundimi i

pamjaftueshëm i ligjit. Duke pasur disproporcion në bilancin e pagesave, ku dominimi i importit është shumë i madh ndaj eksportit si dhe niveli i ulët i konkurrencës të NVM -ve vendore me ato ndërkombëtare ka ndikuar në zhvillimin ekonomik në aspektin makroekonomik, andaj ndërmarrjet eksportuese të dobëta, pengojnë kontributin e mëtejshëm të NVM-ve në Bruto Produktin Vendor, krijimin e vendeve të reja të punës si dhe rritjen ekonomike. Mbi 50% e të gjitha NVM -ve operojnë në sektorin e tregtisë që karakterizohet me investime të vogla dhe joproductive. Sipas ARBK-s në MTI, numri i NVM-ve të regjistruara deri më 30 dhjetor 2010 ishte me i madh se 100.000, të cilat kanë punësuar 216.799 punëtorë ose 62.24 % të totalit të punësuarve në Kosovë. Përcaktimi i madhësisë së ndërmarrjeve në Kosovë bazohet në ligjin e miratuar në vitin 2008, Nr. 03/ L-031 i cili ka plotësuar ligjin 02/ L-5 për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe mesme. Në Republikën e Kosovës përcaktimi i madhësisë së ndërmarrjes bazohet sipas numrit të punëtorëve, ndërmarrjet me numër prej 1 deri në 9 punëtor konsiderohen si mikro ndërmarrje, prej 10 deri në 49 si ndërmarrje të vogla, ndërsa ndërmarrje të mesme i klasifikon nga 50 deri në 249 punëtor.

4. ZHVILLIMI I NVM-VE NË KOSOVË

Zhvillimi i NVM-ve në Kosovë është relativisht i ri, mundë të themi se fillimet e para të mirëfillta NVM-të i kanë pasë në vitin 1999. Ekonomia e Kosovës pas vitit 1999 ka qenë e shtyer nga ndihmat ndërkombëtare, sektori publik dhe remitencat. Ambient që rrethohet dhe vepron jo gjithë herë ka qënë miqësor dhe i favorshëm për këtë sektor. Edhe përkundër vështërsive të shumta, pas luftës mundë të themi se sektori i NVM-ve ka një prirje kah stabilizimi dhe veprimi normal.

Roli i sektorit privat, e në veçanti i NVM-ve nuk kanë pasur rolë të madhe në ekonomi.

Mëqëse Kosova është në fazën e tranzicionit ku krijimi i bizneseve të reja veçse ka filluar ta luajë rolin e vetë në ekonominë e vendit, drejt një ekonomie moderne të tregut të lire dhe si rrjedhim edhe drejt zhvillimit dhe rritjes ekonomike. Sektori i ndërmarrjeve mbetet i dominuar nga ndërmarrjet e vogla dhe mikro ndërmarrjet. Rreth 99.7% të ndërmarrjeve punsojnë më pakë së 50 punëtorë, duke kontribuar rreth 60% të totalit të qarkullimit në ekonomi. Qasja si dhe kostoja e financave ka mbetur problematike, kryesisht për shkak të rreziqeve të larta në ekonomi. Masat për përmirësimin e qasjes në financa për NVM-të janë parashikuar në strategjinë për NVM.

REKOMANDIME

Duke u mbështetur në të dhënat teorike dhe ato praktike, mund të vijmë në konstatimet si në vijim:

Duhet të stimulohet organizimi i ndërmarrjeve në formë të shoqërive aksionare (korporatave) si një formë optimale e cila do të ndikonte në investimin edhe të shumave më të vogla të fondeve financiare që zotërojnë individët dhe familjet dhe në të njëjtën kohë do të ndihmonte në financimin e projekteve që nuk mund të financohen vetëm nga burimet vetanake ose edhe nga kreditë bankare.

Struktura e NVM-ve sipas veprimtarive ekonomike tregon se duhet mbështetur me politika makroekonomike cilësore ndërmarrjet prodhuese dhe shërbyese, në mënyrë që tregu i vendit të furnizohet nga ndërmarrjet prodhuese dhe shërbyese vendore dhe kjo të ndikojë në përmirësimin e bilancit tregtar në vend i cili në Kosovë është shumë brengosës.

Menaxhimi i NVM-ve duhet besuar menaxherëve profesionistë të cilët në bazë të dijes dhe përvojës që e kanë, dinë në mënyrë shumë më të saktë të identifikojnë nevojat e tregut përfshirë kërkesat e furnizimeve, shitjeve, tregun financiar, etj.

Pronarët duhet investuar në vetvete nëse nuk dëshirojnë që biznesin e tyre t'ua drejton dikush tjetër. Kjo nënkupton se ata duhet vijuar trajnime dhe kurse të ndryshme profesionale të fushës së biznesit dhe menaxhimit. Kjo do të krijonte një mundësi më të mirë që vendimet e tyre të jenë më efektive dhe kjo të ndikojë që performanca e bizneseve të tyre të ketë një shkallë më të lartë të rritjes.

Marrja parasysh e rekomandimeve të mësipërme në mënyrë të theksuar do të ndikonte që të ngritët vetëdija dhe aftësia ndërmarrëse, mirëpo edhe do të krijoheshin kushte më të mira për rritjen e investimeve në vend. Rritja e investimeve në vend do të ndikonte që të shfrytëzohet në mënyrë më racionale potenciali i tregut, mirëpo këtë duhet nënkuptuar edhe në nivelin e ekonomisë kombëtare për nga perspektiva e biznesit dhe e ndërmarrësisë.

LITERATURA

- [1] Albers Mohroam, Susan, & Galbraith, Jay R, & Lawler, Edward E.III, Tomorrows organizations, 1998
- [2] Bass, B. M (1990) Bass and Stogdill's handbook on leadership: A survey of theory and research. New York: Free Press.
- [3] Bennis, W.G&Nannus, B (1985). Leaders: Strategies for Taking charge. NewYork: Harper and Row.
- [4] Berdahl, J. L. (1996). Gender and leadership in work groups: Six alternative models.
- [5] Mustafa, Isak. Ndërmarrja në biznesin bashkëkohor, Biblioteka Perspektiva në biznes, Prishtinë, 1997
- [6] Ligji nr.03/l-031 ligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 02/l-5 për mbështetjen e ndërmarrjeve, <http://www.gazetazrtare.com>